



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Flori Rexhepi	10.04.2026	20.04.2026	2026/0214

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.04.2026, OE “AD-STAR”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0214, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “ TONI O.P - Lot 2, HARISI Group shpk- Lot 3,4,5”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Nderhyrje restauruese dhe konservuese ne asetet e Trashegimise Kulturore ne Rajonin e Pejes dhe Rajonin e Deçanit” me nr. të prokurimit: "207-25-9871-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë ,vlera e parashikuar e kontratës: 747,570.60 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

3.1 Shkelja e Nenit 108/A, Paragrafët 3 dhe 6 — Mosrespektim i afatit dhe mungesë njoftimi për zgjatje afati

Neni 108/A, Paragrafi 3 i LPP-së parashikon se AK duhet të vendosë mbi Kërkesën për Rishqyrtim brenda tre (3) ditëve nga pranimi. Kërkesa e AD-STAR u dorëzua më 23.03.2026. Rrjedhimisht, afati ligjor 3-ditor skadoi më 27.03.2026. Vendimi i AK-së u nxor më 30.03.2026. Neni 108/A, Paragrafi 6 i LPP-së parashikon mundësinë e vetme ligjore përmes së cilës AK mund të vendosë pas ditës së tretë: duke njoftuar me shkrim ankuesin për zgjatje të afatit, brenda afatit 3-ditor origjinal. Ky njoftim duhet lëshuar jo më vonë se 27.03.2026. *AD-STAR sh.p.k. konfirmon dhe dëshmon se nuk ka marrë asnjë njoftim nga AK-ja — as me shkrim, as me email, as nëpërmjet platformës elektronike të prokurimit — për zgjatje të afatit të rishqyrtimit sipas Paragrafit 6 të Nenit 108/A, brenda afatit 3-ditor ligjor.* Kjo shkelje përbën cenim të të drejtës për mjet juridik efektiv dhe e bën vendimin absolutisht të pavlefshëm.

3.2 Shkelja e Nenit 7 LPP — Barazia në Trajtim (par. 1, 2 dhe 3)

AK është i obliguar ligjërisht të sigurojë trajtim të barabartë, jo-diskriminim dhe transparencë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Aplikimi i Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016 si kriter eliminimi — pa qenë ky akt pjesë e dosjes — e vendos AD-STAR-in dhe çdo operator tjetër në pozitë të pabarabartë, duke cenuar drejtpërdrejt transparencën e procedurës dhe konkurrencën e drejtë.

3.3 Shkelja e Nenit 27 LPP — Dosja e Tenderit (par. 1)

Dosja e Tenderit duhet të përmbajë të gjitha kriteret dhe kërkesat që do të përdoren gjatë vlerësimit. Udhëzimi Administrativ nr. 16/2016 nuk figuron në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit dhe nuk iu është bërë i njohur operatorëve ekonomikë si kërkesë e detyrueshme para dorëzimit të ofertave. Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të KRPP-së (RRUOPP), "dosja e tenderit duhet të përgatitet në mënyrë të tillë që të mos ketë nevojë për informata shtaruese shtesë" dhe "kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike

3.4 Shkelja e Nenit 51 LPP — Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes (par. 1)

Kriteret e përzgjedhjes duhet të përcaktohen paraprakisht, të përfshihen shprehimisht në dosjen e tenderit dhe të jenë të qarta e të barabarta për të gjithë. Kriteri i nostrifikimit të diplomave nuk ka qenë i përcaktuar si kriter përzgjedhjeje në asnjë prej dokumenteve të procedurës. Çdo vendim eliminimi bazuar mbi të është proceduralisht i pavlefshëm

3.5 Shkelja e Nenit 56 LPP — Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen (par. 1 dhe 2)

Refuzimi i një oferte është i ligjshëm vetëm kur ajo nuk përmbush kërkesat e specifikuar në dosjen e tenderit. Oferta e AD-STAR-it është refuzuar mbi bazën e një kushti që nuk ekziston në dosje, gjë që e bën refuzimin krejtësisht të pabazuar dhe të paligjshëm

3.6 Shkelja e Nenit 59 LPP — Ekzaminimi dhe Vlerësimi i Tenderëve (par. 4)

Vlerësimi i ofertave duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kriterëve të publikuar. Sipas Paragrafin 4 të Nenit 59, përdorimi i Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016 — i cili nuk është pjesë e dokumenteve të tenderit — përbën tejkalim kompetencash dhe vlerësim të paligjshëm. AK nuk mund të zëvendësojë kërkesat e dosjes me interpretime administrative të ministrive të tjera, të cilat nuk kanë fuqi normative detyruese në procedurat e prokurimit.

KRITERET PËR VLERËSIM

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “AD-STAR”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit” me numër të prokurimit: “207-25-9871-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa numër 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë qarkullim në tri vitet e fundit për LOT 1 si në vijim, së paku 296,960€, për LOT 2 Operatori Ekonomik duhet të ketë qarkullim në tri vitet e fundit si në vijim, së paku 823,033.00€, për LOT 3 Operatori Ekonomik duhet të ketë qarkullim në tri vitet e fundit si në vijim, së paku 200,000.00€, për LOT 3 Operatori Ekonomik duhet të ketë qarkullim në tri vitet e fundit si në vijim, së paku 823,033.00€, për LOT 4 Operatori Ekonomik duhet të ketë qarkullim në tri vitet e fundit si në vijim, së paku 75,746.00€, për LOT 5 Operatori Ekonomik duhet të ketë qarkullim në tri vitet e fundit si në vijim, së paku 99,401.00€ Vërejtje Nese OE apo GOE ofertojnë në të dy LOT- et ofertimi duhet të bëhet sipas rregullave të nenit 18.5 dhe 18.9 të Rregullores nr. 002 2024 për Prokurimin Publik	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kopjet e Deklaratave Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit (prej datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë – Formularit B05) ose Raportin e Pasqyrave të Audituarra. Vërejtje Nese OE apo GOE ofertojnë në të dy LOT- et ofertimi duhet të bëhet ofrohen sipas rregullave të nenit 18.5 dhe 18.9 të Rregullores nr. 002 2024 për Prokurimin Publik
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional: Kriteri numër 1. ISO 9001-2015 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë Kriteri numër 2. Caktimi i Menaxherit të kontratës	Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. ISO-standardet e paraqitura për plotësim duhet të dëshmohen si dokumente valide. 2. Vendimi për përcaktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë Master ose Inxhinier i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë-konstruktiv. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedurës, numrin e prokurimit). Menaxheri i kontratës duhet të prezantojë a. Diplomën universitare. b. Kontratën e punës (të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës së paku 5 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose të punëve të ngjashme (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga i angazhuari). d. Së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave – mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme; Së paku njëri nga stafi i angazhuar, qoftë menaxheri i kontratës qoftë njëri prej inxhinierëve nga lista e

		stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencë A1. Në rast të posedimit të Licencës A1 - për hartimin e projekteve për konservim restaurim dhe mbikëqyrje të implementimit në fushën e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, duhet të prezantohet vetëm kopja e licencës ose kopja e vendimit të Bordit të Licencimit që është i licencuar në kategorinë A1; Kontratën ose parakontratën me O.E. - të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE; dhe së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave – mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme.
	Kriteri numër 3. Lista e stafit profesional 3.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master) 3.2. Një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) 3.3 Një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (ose Master) drejtimi hidroteknik 3.4 Një (1) Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (ose Master) 3.5 Një (1) Inxhinier i diplomuar i makinerisë (ose Master)	3. E gjithë lista e stafit të kërkuar në kërkesën numër 2 nga Autoriteti kontraktues duhet të ketë a. Diploma universitare. b. Kontrata e punës ose parakontratë (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës së paku 5 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga i angazhuari) për pikën 3.1 dhe 3.2; dëshmi për përvojë të punës së paku 2 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga i angazhuari) për pikën 3.3, 3.4 dhe 3.5. d. Dëshmi për së paku një referencë të punës që ndërlidhet me njërin nga natyrat e punës në restaurim ose konservim ose renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore, përjashtimisht pikave 3.2, 3.3, 3.4 dhe 3.5 ku nuk kërkohet dëshmi.
	Kriteri numër 4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një listë të vulosur dhe të nënshkruar, ku duhet të përmbajë së paku 20 punëtorë profesional dhe mbështetës. Lista e paraqitur duhet të përmbajë të dhënat Emri dhe mbiemri, të dhënat personale, eksperiencia dhe funksioni brenda kompanisë apo punët që do t'i kryejë në projekt 4.1. Së paku 1 (një) - Teknik të ndërtimtarisë 4.2. Së paku 1 (një) – Teknik të elektroteknikës 4.3. Së paku 1 (një) - Konservues Restaurues i strukturave të drurit (Licenca A2-2) 4.4. Së paku 1 (një) - Konservues Restaurues i strukturave të gurit (Licenca A2-1) 4.5. Së paku 10 punëtorë në punë të ndryshme, si p.sh. shtrues pllakash, suvatues, instalues, mjeshtër kulmi, llamarinë punues, saldues, etj. 4.6. Së paku 6 punëtorë fizik.	4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një listë të vulosur dhe të nënshkruar, ku duhet të përmbajë së paku 20 punëtorë teknik profesional dhe mbështetës. Lista e paraqitur duhet të përmbajë të dhënat si Emri dhe mbiemri, të dhënat personale, eksperiencia dhe funksioni brenda kompanisë. 1. Për stafin 4.1, 4.2 Duhet të paraqiten diplomat e shkollimit të mesëm. Duhet të kenë së paku 3 vite përvojë pune (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga punëtori) dhe secili duhet të paraqesë dëshmi që ka së paku një referencë në trashëgimi kulturore ose punë të ngjashme. Kontrata e punës ose parakontratë (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). 2. Për stafin numër 4.3, dhe 4.4 Kontrata e punës (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE) dhe kopjet e licencave përkatëse A2-1, A2-2, ose kopjet e vendimit të Bordit të Licencimit. 3. Për stafin numër 4.5 duhet të kenë së paku 3 vite përvojë pune (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga punëtori) dhe Kontrata e punës (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). 4. Për stafin numër 4.6 duhet të paraqiten Kontratat e punës (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE).
	Kriteri numër 5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një Listë të pajisieve që nevojiten për	5. Dëshmitë për listën e pajisjeve; a. Të gjitha pajisjet duhet të jenë në pronësi të aplikuesit dhe në rast të marrjes me qira (duhet të kenë kontratë për

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “AD-STAR”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit” me numër të prokurimit: “207-25-9871-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

		projektin në fjalë (e që duhet të jenë) 5.1. Kamionetë 5.2. Kamion kiper me kran – 1 Copë 5.3. Skele – minimum 300m2 5.4. Një Gjenerator (Agregat).	huazim – marrje me qira e cila kontratë duhet të jetë valide për projektin në fjalë). b. Për artikujt 5.1 dhe 5.2 duhet të kenë librezat valide. c. Të gjithë artikujt (përveç atyre motorike) të dëshmohen edhe me Faturën e blerjes.
		Kriteri numër 6. O.E. duhet të dorëzoj me shkrim deklaratën që e ka kuptuar tenderin (shpalljen) dhe ka siguruar materialet dhe pajisjet e kërkuara në tender	6. O.E. duhet të dorëzojë së bashku me dokumentet tjera për aplikim në tender edhe një deklaratë të nënshkruar dhe vulosur se i ka të qarta kërkesat (materialet, pajisjet, veglat, orenditë,...) e paramasës dhe parallogarisë në tender.
		Kriteri numër 7. O.E. duhet të siguroj nuk ka me shume se tri kontrata aktive me MKRS-ne të natyrës së njëjtë, respektivisht në planin dinamik të punës nuk mund të jetë i njëjti arkitekt i licencuar ose mjeshtër i licencuar i angazhuar në më shumë se tri kontrata tjera të natyrës së njëjtë.	7. Nëse vlera e kontratës në të cilën stafi i licencuar është i angazhuar ka vlerë nën 100,000.00 euro ky kriter nuk zbatohet. Nëse O.E. konkurren në disa projekte restauruese në planin dinamik të punës nuk mund të figurojë i njëjti arkitekt i licencuar, ose mjeshtër i licencuar në më tepër se tri kontrata i angazhuar në të njëjtën kohë (njëjtat data kalendarike).

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministartstvo Kulture, Omaladine i Sporta –Ministry of Culture, Youth & Sports

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit

Nr i prokurimit	207-25-9871-5-1-1
Nr i brendshëm	207-25-117-5-1-1

Radhë	LOT I Konservim dhe Restaurim- Kulla e Hamëz Mataj, Baballoq, Deçan	Çmimi total	Statusi:
1.	AD STAR	140034.75	I eliminuar

Radhë	LOT II Konservim dhe Restaurim- Shtegu i Mijëvjeçarit- Shpella e Zeze, Belle, Deçan	Çmimi total	Statusi:
1.	AD STAR	377,104.38	I eliminuar
2.	TONI O.P., 811152420	419,714.89	I suksesshëm
3.	IDEAL PARTNERS SH.P.K., 811913997	443,874.95	I pasuksesshem
4.	"HARISI GROUP" SH.P.K., 810002775	446,189.69	I pasuksesshem
5.	Çeta -General Invest Group, 810298621	477,058.48	I pasuksesshem

Radhë	LOT III Konservim dhe Restaurim- Konaku i Haki Spahiut, Pejë	Çmimi total	Statusi:
1.	AD STAR	93,221.26	I eliminuar
2.	"HARISI GROUP" SH.P.K., 810002775	95,898.86	I suksesshëm
3.	Çeta -General Invest Group, 810298621	99,461.91	I pasuksesshem

Radhë	LOT IV Konservim dhe Restaurim- Kulla e Haxhi Zekës në Leshan	Çmimi total	Statusi:
1.	"HARISI GROUP" SH.P.K., 810002775	34,978.00	I suksesshëm
2.	Çeta -General Invest Group, 810298621	36,598.00	I pasuksesshem
3.	AD STAR	37,276.00	I eliminuar

Radhë	LOT V Konservim dhe Restaurim- Lokali Panda, Pejë	Çmimi total	Statusi:
1.	"HARISI GROUP" SH.P.K., 810002775	45,053.40	I suksesshëm
2.	AD STAR	46,398.00	I eliminuar
2.	Çeta -General Invest Group, 810298621	48,112.21	I pasuksesshem
3.	TONI O.P., 811152420	48,245.92	I pasuksesshem

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “AD-STAR”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit” me numër të prokurimit: “207-25-9871-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Kanë ofertuar pesë (5) Operator Ekonomik, në lloje të ndryshme.

Shperblehen me kontratë si vijon:

Nr:	Grupi:
LOT 1	Anulohet
Radhë	LOT II – Shperblehet me kontratë
2.	TONI O.P. 811152428
Radhë	LOT III – Shperblehet me kontratë
3.	"HARISI GROUP" SH.P.K. 810002775
Radhë	LOT IV – Shperblehet me kontratë
4.	"HARISI GROUP" SH.P.K. 810002775
Radhë	LOT V – Shperblehet me kontratë
5.	"HARISI GROUP" SH.P.K. 810002775


 Data: 19.03.2026
 Valbonë ZEKAJ

 Zv. Drejtor i Prokurimit /MKRS

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - AD-STAR

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me Vendimin (B58) të AK-së, për dhënie të kontratës ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues, sqaron se Autoriteti kontraktues pas pranimi të ofertave ka formuar komisionin për vlerësimin e ofertave dhe ne përfundim të vlerësimit të ofertave i njofton operatorët ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet të prokurimit lidhur m rezultatin e vlerësimit të ofertave, ku OE ankues njoftohet si tenderues i eliminuar ne te gjitha Lotet.

OE ankues eliminohet me arsyetimin si më poshtë:

Të Kërkesat e paraqitura nga AK-MKRS, Operatori Ekonomik AD STAR nuk plotëson kriteret:

AD-STAR – I eliminuar – Lot 1. 140,034.75€, Lot 2. 377,104.38€, Lot 3 93,221.26€, Lot 4. 37,276.00€, Lot 5. 46,398.00€ - Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se stafi i paraqitur (inxhinierët) nuk posedon dëshmi për nostrifikimin, përkatësisht njohjen dhe barazvlerësimin e diplomave të fituara jashtë Republikës së Kosovës.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016 për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, konkretisht nenit 3 (Parimet e përgjithshme dhe barazvlera), pika 6, përcaktohet se shtetasit e huaj janë të obliguar të kërkojnë njohjen dhe barazvlerësimin e diplomave dhe kualifikimeve të arsimit të lartë të fituara jashtë Republikës së Kosovës, nëse për këtë kanë interes juridik në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, për të ushtruar veprimtari profesionale ose për t'u angazhuar në institucione brenda Republikës së Kosovës, është e domosdoshme që diplomat e fituara jashtë vendit të jenë të njohura dhe të barazvlerësuar nga autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

OE ankues pretendon se ne dosje të tenderit nuk ekziston kërkesa për nostrifikimin e diplomave rrjedhimisht deklaron se jemi eliminuar për një kërkesë qe nuk është parapare ne dosje te tenderit.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dëshmimeve, konkretisht kërkesës se dosjes se tenderit vlerëson se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, sepse një kërkesë e tille nuk ekziston ne dosje te tenderit dhe eliminimi i një operatori ekonomik për një kërkesë qe paraprakisht nuk është parapare ne dosje te tenderit është ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-se, ku përcaktohet që:

Neni 56.3 i LPP-se:

“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kritერი që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “AD-STAR”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit” me numër të prokurimit: “207-25-9871-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **AD-STAR**

Florije Rexhepi

